

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **QENDRA E SHËNDETIT MENDOR DHE SHTËPIA INTEGRUESE NË BASHKËSI MITROVICË**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	220/71206-26-5403-1-2-1
Nr i brendshëm	005-2026

Sa i përket tenderit për: **“Furnizim me material higjienik- në kohëzgjatje prej 24 muaj,Për-QSHM-Mitrovicë,QSHM-SKENDERAJ,DY SHTËPI INTEGRUESE NËMITROVICË.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

PM GROUP SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.Anton Ceta Nr.3

(Adresa)

Prishtinë

10 000

(Vendi)

(Kodi postar)

+38348881999

N/A

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Pashtrik Mustafa

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

shpkpmgroupp@gmail.com

(Adresa elektronike)

10.08.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 08.07.2026
Data e hapjes së ofertave dt. 27.07.2026
Njoftimi mbi vendimin i dt. 29.07.2026
Kërkesa për rishqyrtim e dt.02.08.2026
Vendimi për refuzimin e kërkeses për rishqyrtim 05.08.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☐

Jo

☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 61 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 40 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik

Neni 41 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik.
Nenin 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve;

Nenin 60 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik – Kriteret për Dhënien e Kontratës.

**** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjabë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.**

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

I. DISPOZITAT E SHKELURA

PM GROUP Sh.P.K., në cilësinë e operatorit ekonomik pjesëmarrës dhe palës së interesuar në aktivitetin e lartcekur të prokurimit, paraqet këtë ankesë kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues të datës 05.08.2026.

Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues, gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, si dhe gjatë shqyrtimit të pretendimeve të ngritura në Kërkesën për Rishqyrtim, ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në veçanti me:

Nenin 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;

Nenin 60 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik – Kriteret për Dhënien e Kontratës.

Më datë **29.07.2026**, Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin, ndërsa pas qasjes në dokumentacionin e Operatorit Ekonomik të rekomanduar për kontratë, PM GROUP Sh.P.K. ka paraqitur më **02.08.2026** Kërkesë për Rishqyrtim, duke evidentuar mangësi konkrete në dokumentacionin e OE të rekomanduar.

Megjithatë, me Vendimin e datës 05.08.2026, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar kërkesën tonë si të pabazuar, pa i rrëzuar me prova konkrete pretendimet e ngritura dhe pa arsyetuar se si dokumentacioni i OE të rekomanduar i përmbush kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

PRETENDIMI I PARË

OE i rekomanduar nuk ka dëshmuar kryerjen e vlerësimit të riskut për të gjitha pozicionet

Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit ka përcaktuar në mënyrë të qartë dhe të shprehur kërkesën:

“OE të dëshmojë se ka kryer vlerësimin e riskut për të gjitha pozicionet konform Ligjit Nr. 04/L-161.”

Formulimi i kësaj kërkeje është i qartë dhe obligativ. Dosja e Tenderit nuk ka kërkuar thjesht ekzistimin e një akti apo deklarate për vlerësimin e riskut, por ka kërkuar shprehimisht që vlerësimi të jetë kryer **“për të gjitha pozicionet”**.

Pas qasjes në dokumentacionin e OE të rekomanduar për kontratë, është konstatuar se **DEMOS Sh.P.K.** ka dorëzuar një Deklaratë mbi përfundimin e aktit të vlerësimit të riskut, në të cilën figurojnë vetëm dy pozita pune: **Drejtor** dhe **Depoist**.

	N.N. "BLITERM" (Unit: PCG - ProtecConsultingGroup) LICENCA NR: 04/2018 - MPMS (Mënyra e Punës dhe Mirëmbajtjes Sociale) Udhëkryqi: 11/2017 - AUTODITIMI: 14/2017 - AME (Agjencioni i Menaxhimit të Financimit në Kosovë)	DATA E PËRGADITJES: 18.12.2025
	TEMA: DEKLARATË MBI PËRFUNDIMIN E AKTIT TË VLERËSIMIT TË RISKUT	1 of 1

**DEKLARATË
MBI PËRFUNDIMIN E AKTIT TË VLERËSIMIT TË RISKUT**

Mbi bazën e aktit përfundimtar të deklaratës së vlerësimit të riskut për pozitat e punës në kompaninë "DEMOS" SH.P.K. (NUI: 812043264) ku synim kryesor ka përmirësimin e kushteve të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë (SSHP). Deklarojmë se janë përmbushur detyrimet ligjore në lidhje me projektin, duke përfshirë në vlerësim të gjitha profesionet, makineritë, pajisjet, materialet, instalimet, vendet e punës dhe hapësirat në ndërmarrje sipas aktivitetëve punuese të deklaruar nga Kompania.

Vlerësimi ju nënshtrohet kësaj pozite:

- DREJTOR
- DEPOIST

Në këtë pozita punë të prezantuar nga kompania e lartë-përmendur janë bërë shqyrtimet elektro-energjetike, Tokëzimi dhe rezistenca reziduale dhe kushtet mikro-klimatike dhe shqyrtimet e proceseve prodhuese sipas prezantimit të mjeteve dhe dokumentacionit teknik të drejtorit të kompanisë.

Procesi i vlerësimit të riskut, procedura e përdorur dhe mënyra e vlerësimit janë bazuar në Ligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 04/L-161 dhe Rregulloret që dalin nga ky ligj, si dhe Direktivat Evropiane për Vlerësimin e Rrezikut në Vendin e Punës.

Kompania duhet të paraqes për vlerësim pozitat e reja në punë, që nuk janë të përfshira në këtë punim dhe të ndjek rregullat dhe rekomandimet efektive sipas udhëzimeve dhe kërkesave ligjore.

Pas deklarimit që projekti do të rishikohet sipas kërkesave ligjore e në veçanti në Ndërmirësim të teknologjisë, pas një aksidenti ose incidenti/avarie, apo faktorëve tjerë relevant që mund të krijohen/ndikohen nga procesi i punës apo procese tjera. Kjo do të zbatohet duke informuar kompaninë vlerësuese në kohën e paraparë, sipas proceseve dhe ligjeve në fuqi.

Të njohohen organet gjegjëse me kohë dhe në çdo moment të nevojshëm me qëllim të të kryerjes së detyrave menaxhuese në nivel sa më të lartë.

Pas pajtimit dhe deklarimit që rekomandimet do të merren me seriozitet dhe të zbatohen në përpikëri me qëllim të ngritjes së nivellit të sigurisë në gjithë proceset punuese.

Personat përgjegjës Menaxher, Mirëmbajtje dhe të gjithë të punësuarit, duhet të njohin çdo herë personin e sigurisë në kompani dhe kompaninë vlerësuese, mbi ndryshimet e proceseve apo pa qartësi në teren me qëllim të marrjes së masave adekuata, në të kundërtën Kompania Vlerësuese BLITERM (Nr.04/2018), vendimi për Çertifikim (100/2022 MPMS), nuk merr përgjegjësi mbi proceset dhe tërë kjo ngarkohet/pranohet nga personat përgjegjës të kompanisë "DEMOS" SH.P.K.

Prishtinë, Dhjetor, 2025

Kompania:
"DEMOS" SH.P.K.





Nga dokumenti i paraqitur nuk rezulton se vlerësimi i riskut është kryer për **të gjitha pozicionet**, ashtu siç është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues.

Përkundër këtij fakti, në Vendimin mbi Kërkesën për Rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar pretendimin tonë me arsyetimin se **“nuk është kërkuar fare për pozita të caktuara”**.

Ky arsyetim nuk e ardhson dhe nuk e rrëzon pretendimin ankimor.

Ankuesi nuk ka pretenduar se Dosja e Tenderit ka kërkuar emërtime të caktuara të vendeve të punës. Pretendimi ynë ka qenë dhe mbetet se **Autoriteti Kontraktues ka kërkuar vlerësimin e riskut për të gjitha pozicionet, ndërsa OE i rekomanduar ka paraqitur dokument në të cilin evidentohen vetëm dy pozita.**

Fakti se AK nuk i ka emërtuar individualisht pozitat në Dosjen e Tenderit nuk e ndryshon përmbajtjen e kërkesës dhe nuk e eliminon detyrimin e OE për të dëshmuar se vlerësimi i riskut është kryer për të gjitha pozicionet relevante.

Përkundrazi, me pranimin si të mjaftueshëm të një dokumenti që evidenton vetëm dy pozita, Autoriteti Kontraktues praktikisht e ka reduktuar kërkesën e Dosjes së Tenderit nga **“të gjitha pozicionet”** në disa pozicione të përzgjedhura, pa dhënë asnjë bazë faktike apo juridike për një përfundim të tillë.

Kërkesa ne dosjen e tenderit për automjete e përforcon mospërputhjen

Vetë Dosja e Tenderit kërkon që Operatori Ekonomik të posedojë së paku **dy automjete bartëse pick-up me pesë dyer dhe së paku një kamion me lift.**

Realizimi i transportit, ngarkimit, shkarkimit dhe shpërndarjes së furnizimeve përmes këtyre mjeteve presupozon angazhimin e personelit përkatës. Megjithatë, në dokumentin e paraqitur nga OE i rekomanduar nuk figuron asnjë pozitë që lidhet me këto aktivitete, por vetëm pozitat **Drejtore dhe Depoist.**

Ky fakt nuk paraqitet si krijim i një kriteri të ri apo si pretendim se Dosja ka kërkuar shprehimisht pozitën “shofer”. Përkundrazi, ai paraqet një rrethanë konkrete që dëshmon se AK nuk ka mundur ta konsiderojë automatikisht dokumentin me vetëm dy pozita si dëshmi të mjaftueshme për kriterin **“vlerësimi i riskut për të gjitha pozicionet”**, pa verifikuar dhe arsyetuar përmbushjen e plotë të kësaj kërkesë.

Sipas **nenit 59 të LPP-së**, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit. Autoriteti Kontraktues nuk mund të shpallë një ofertë të përgjegjshme duke anashkaluar një pjesë materiale të një kërkesë të përcaktuar nga vetë ai.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se OE i rekomanduar **nuk ka dëshmuar përmbushjen e kërkesës në formën dhe përmbajtjen e përcaktuar në Dosjen e Tenderit**, ndërsa AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së duke e trajtuar ofertën si të përgjegjshme.

PRETENDIMI I DYTË

OE i rekomanduar nuk ka dorëzuar Deklaratën për Specifikimet Teknike dhe është dashur të eliminohet si i papërgjegjshëm pasi që ishte në Dosjen e tenderit tek pika 3.1

Specifikacionet teknike të detyrueshme	3.1	Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë: a. Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit.
--	-----	---

Në Dosjen e Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar dorëzimin e **Deklaratës për Specifikimet Teknike**, si dokument përmes të cilit Operatori Ekonomik dëshmon pajtueshmërinë e mallrave të ofruara me specifikimet teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Gjatë qasjes në dokumentacionin e OE të rekomanduar për kontratë, është konstatuar se **Deklarata për Specifikimet Teknike nuk është dorëzuar nga OE i rekomanduar dhe nuk ka qenë pjesë e dokumentacionit të ofertës që na është vënë në dispozicion për qasje**. Këtë mangësi e kemi ngritur shprehimisht edhe në Kërkesën për Rishqyrtim.

Mungesa e këtij dokumenti nuk mund të konsiderohet mangësi formale, pasi bëhet fjalë për një dokument të kërkuar nga vetë Autoriteti Kontraktues për të dëshmuar përmbushjen e specifikimeve teknike. Për rrjedhojë, **OE i rekomanduar nuk e ka përmbushur një kërkesë të Dosjes së Tenderit dhe oferta e tij është dashur të eliminohet si e papërgjegjshme gjatë fazës së ekzaminimit dhe vlerësimit të tenderëve**.

Pavarësisht kësaj, Autoriteti Kontraktues, në vendimin për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë që do ta kundërshtonte këtë fakt, por është kufizuar në konstatimin e përgjithshëm se **“janë përmbushur të gjitha kushtet”**.

Nëse pretendimi ynë do të ishte i pasaktë dhe OE i rekomanduar do ta kishte dorëzuar Deklaratën për Specifikimet Teknike, **Autoriteti Kontraktues kishte mundësi të plotë që këtë ta dëshmonte menjëherë, duke e identifikuar dhe bashkëngjitur dokumentin përkatës në vendimin me të cilin ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim**. Mosparaqitja e një prove të tillë, përkundër pretendimit tonë të drejtpërdrejtë për mungesën e dokumentit, e lë të pakundërshtuar faktin e konstatuar gjatë qasjes.

Prandaj, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me **nenin 59 të LPP-së**, duke e konsideruar të përgjegjshme një ofertë e cila nuk përmban dokumentin e kërkuar për përmbushjen e specifikimeve teknike.

Për rrjedhojë, OE i rekomanduar është dashur të shpallet i papërgjegjshëm dhe të eliminohet nga procedura, ndërsa aktiviteti i prokurimit të vazhdojë me operatorin ekonomik të radhës që i plotëson të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit.

IV. SHKELJA E NENEVE 59 DHE 60 TË LPP-së

Nga faktet e paraqitura rezulton se Autoriteti Kontraktues e ka konsideruar ofertën e OE të rekomanduar si të përgjegjshme pa dëshmuar se janë përmbushur në tërësi kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Në njërën anë, kërkesa e Dosjes ka qenë e qartë për **vlerësimin e riskut për të gjitha pozicionet**, ndërsa dokumentacioni i vënë në dispozicion evidenton vetëm dy pozita. Në anën tjetër, lidhur me Deklaratën për Specifikimet Teknike, AK nuk ka dhënë provë konkrete se dokumenti i kërkuar ka

qenë pjesë e ofertës së dorëzuar.

Këto mangësi kanë ndikim të drejtpërdrejtë në përcaktimin nëse tenderi i OE të rekomanduar është tender i përgjegjshëm.

Në kuptim të **nenit 59 të LPP-së**, AK është i obliguar që tenderët t'i ekzaminojë, vlerësojë dhe krahasojë në përputhje me kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në dokumentacionin e prokurimit.

Ndërsa sipas **nenit 60 të LPP-së**, dhënia e kontratës bëhet mbi bazën e tenderit të përgjegjshëm sipas kriterit të përcaktuar për dhënien e kontratës.

Rrjedhimisht, kriteri ekonomik për dhënien e kontratës nuk mund të aplikohet në favor të një tenderi pa u konstatuar paraprakisht se ai i plotëson kërkesat e detyrueshme të Dosjes së Tenderit.

Pranimi i dokumentacionit që nuk dëshmon kërkesën në përmbajtjen e saj të plotë, apo konsiderimi si të përmbushur i një kriteri pa identifikuar dokumentin përkatës, cenon ligjshmërinë e procesit të ekzaminimit dhe vlerësimit të tenderëve.

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e **OE PM GROUP SH.P.K**

ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së (formulari B58) dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM** dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve na janë shkaktuar dëme në vlerë rreth 5 mijë euro deri më tani.
--

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*

- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*